Molisja megjithatë nuk vërehej edhe aq tek ne mësimdhënësit e gjimnazit Loyola-Gymnasium ngase jemi të vetëdijshëm se qasja ndaj civilizimit njerëzor reflekton shkallën e qytetërimit tonë. Me iniciativën e drejtorit të shkollës P.Happel ( ai përmes formave të ndryshme ishte pajisur me një informacion të bollshëm për pikat më të rëndësishme të civilizimit antik të rrethit të Sarandës) shkua me një kishë paleokristiane e hulumtuar dhe e studiuar mirë nga Aleksandër Meksi, një ekspert i arkitekturës dhe historisë antike e mesjetare. Prej nga ky emër Mesopotami? Meqë kisha shtrihej në mesin e dy lumenjve e kishte marrë këtë emër nga greqishtja meso-mes dhe potham -lumë. Më pas ishte koha e një relaksi. Aty afër Mesopotamit buzë lumit Bistricë që burimin e kishte tek Syri i Kaltër, vend shumë turistik mes Gjirokastrës dhe Sarandës, vendosëm që ta qerasim veten me një drekë të këndshme. Bëmë ushqim në skarë, ndërsa në veçanti u dalluan kolegët, por edhe pronarët e kompanisë "Nderimi" që na bartën me autobus. Birrat ishin edhe më të këndshme nën aromën provokuese të mishit të pjekur. Momente të mira për humor e batutat që për një çast do të na shpëpusnin nga përditshmëria që ndonjëherë ishte edhe e mundimshme. Thjesht një "fikje truri" nga përditshmëria dhe në vend të saj relaks mëse i domosdoshëm.

### Vizita në Butrint

Të nesërmen u nisëm për në perlën e kulturës dhe civilizimit antik, në Butrint. Fillimisht kërkuam një ciceron, por ishin shumë të ngarkuar me turistë që pos ne arsimtarëve të shkollës sonë, të gjithë ishin nga vende të ndryshme të Europës. Po cilat ishin arsyet që në Butrint kishte aq shumë vizitorë? Ishin arsyet e njëjta që drejtori ynë kishte vendosur që së bashku me ne ta viziton Butrintin. Ishte histroia dhe misteri që lidhej me këtë qytet sa i përket kohës së themelimit të tij. Ishin objektet monumentale që shënonin një epokë, jo vetëm antike por edhe mesjetare. Ishin artefaktet e ndryshme që reflektonin shekujt më tërë shkëlqimin e vet. Kureshtja dhe emocionet që të ngrit ky qytet i lashtë ishin ndër arsyet tjera ... Historia e qytetit është e lidhur me një



## Një vizitë pune dhe rekreative me interes të veçantë në jug të Shqipërisë

vello mistike. Sipas poetit romak Virgjili qyteti lidhet me princin legjendar trojan Eneun pas shkatërrimit të Trojës erdhi në vendin ku sot ndodhet Butrinti, në pritje për të realizuar profecinë se ai aty do ndërtonte një Trojë të re. Ndërsa autori tjetër Teukri i Cizikut themelimin e qytetit të Butrintit ia atribuon princit tjetër trojan, Helenit, i cili tek po bënte fli një dem për nder të zotrave, i shpëton nga duart dhe i plagosur hidhet në ujë dhe doli në breg ku më pas ngordhi. Heleni e mori këtë si shenjë dhe dëshirë të përendive dhe themeloi qytetin të cilin e quajti "Buthrotos".

Lidhur me themelimin e qytetit të Butrintit ka edhe shumë legjenda, por ato si të tilla nuk reflektojnë një shpjegim real. Faktet më reale janë muret pellazgjike të cilat flasin se qyteti është ngritur aty diku rreth shekullit VI para K që e vërteton edhe Hekateu i Miletit, ku në shekullin VI para K thotë se qyteti ishte i fortifikuar. Butrinti bënte pjesë në Federatën e fiseve epirote, përkatësisht të kaonëve dhe prasaibëve. Më vonë qyteti kolonizohet nga grekët gjë që vërtetohet edhe nga muret e dyta rrethuese për t'u bërë një qendër e rëndësishme ekonomike e politike në pjesën e Epirit Verior. Se ishte një qendër e tillë më shtyn të mendoj edhe Cezari i cili në librin e tij "Bellum Civile" thotë: "Caesar eo tempore cum legione una profectus ad recipiendas ulteriores civitas et rem frumentariam expediendam qua angusta utebatur, at Buthrotum oppidum Corcyrae". ("Në këtë kohë, Cezari, kishte shkuar për të shtënë në dorë, me një legjion, disa qytete të largëta për të rregulluar furnizimin e ushtrisë; ishte ngusht me ushqime, sepse këto ndodheshin në Buthros afër (përballë) Korkyrës.")

Historia, objektet monumentale, amfiteatri, bazilika, kalaja e Vivarit dhe objekte tjera lanë mbresa tek të gjithë ne dhe ndiheshim më të privilegjuar që patëm rastin të jetojmë çaste me një civilizim shumëkulturore që i takon njerëzimit. Prandaj të gjithë ne e ndienim në njëfarë forme atë që kishte ndierë shekuj më parë Terenci romak se: "çdo gjë që është njerëzore e konsideroj edhe timen".



Të tillë e konsideruam edhe elegancën e kulturës dhe civilizimit që ofronte qyteti i lashtë antik, Apollonia, në vazhden e vizitave që drejtori P. Happel kishte planifikuar për ne mësimdhënësit e Loyola-Gymnasium-it. E si të mos vizitohet edhe biblioteka e shkollës së Apollonisë në të cilën kishte marrë leksionet e tij shkollorë të kohës perandori i parë dhe me nam romak, Oktavian Augusti. Jo pa arsye thuhet se shekujt janë të pamëshirshëm, por të drejtë. Me xhelozë ruajnë shkëlqimin e çdo gjëje që ka vlerë. Ne e pamë atë shkëlqim.

## SARANDA Prof. Skender Berisha

*Diell i kuqremtë  
kaltëron te sytë  
ku mbeti gjumi  
moj mike  
ku treti a thua*

*Saranda u zgjua  
në sytë e tu  
sa bukur  
moj mike*

*Gjurmë kaltërsie  
enden si gëzimi  
i shtohen bukurisë  
si çlirimi  
moj mike*

*Hajde dalim pak  
te Saranda  
ku po shtrohet  
eranda  
atje te veranda  
të rrimë vetëm pak  
moj mike*

Sarandë, 31 maj 2012

## BUTRINTI Prof. Skender Berisha


*Amfiteatri i shpirtit tim tash po më flet  
gjuhën e vjetër ngadalë po ia shfletoj  
si gjethet e rëna frymë vjeshte që i palon  
me pak ujë nga pusët tua tash po të ujoj*

*rrëzë mureve kërkoj nëpër myshkun tënd  
më flasin gurët gjigantë të palosur gacë  
si prej më të mirës dorë arkitekturore  
dhe ty kthinave të errëta të mbaj për dore*

*ti e lashtë krejt myshk prej pusit më dole  
e nemitur nga gëzimi prapë që më takove  
mermerit i the më tutje moj e bukura e ujit  
ndal ti ndal unë ec ti ec unë e s'më del hujt*

*u lodhëm së ecuri për një ditë tre mijë vjet  
dërrmuar shpirtin psherëtima u krodhëm në det  
te peshqit te amforat e zbrazëta e të plota  
veç valëve e algave nuk na zë kurrë shqota*

Butrint, 1 qershor 2012



## Schule

**31.05. – 03.06.2012**  
**The Trip to the South of Albania**  
**Prof. Mark Gojani**

Saranda is a beautiful seaside town in the south of Albania. Except for the hot climate and beautiful beaches in the vicinity of the town, the region has many monuments from the antique times.

We have chosen precisely this place for an educational three day excursion.

We left on Thursday afternoon, at the last weekend of May, after the end of the lessons. We had a long trip, more than ten hours, of course with short breaks. We arrived in Saranda late in the evening. After the night rest, the following day in the morning we had a session in which the director of Loyola-Gymnasium, Walter Happel SJ made a retrospective of 2011/12 school year before its end. Then we left for Fenichi, an antique locality, 10 km away from Saranda, which hadn't been explored properly yet. On the way back we visited the old monastery in Mesopotam, and had a barbecue in a field by the river. After we returned to Saranda we took the opportunity, our free time, to take a walk in this beautiful seaside town.

Next destination in Saturday was Butrint, a very interesting antique locality, 18 km away from Saranda. After visiting every part of this locality, the amphitheatre, the castle and other remains dating from the beginning of the first centuries AD, we returned to Saranda for a free afternoon and evening. Whereas the following day, after breakfast, we left for Vlorë and visited Apollonia, another antique locality, near the city of Fier.

We took the opportunity of the other part of the trip to visit the house of independence in Vlorë, then continued in the direction of Prizren, where we arrived in the evening to get ready for the new school day.



## Shkolla

**31.05. – 03.06.2012**  
**Udhëtimi në jug të Shqipërisë**  
**Prof. Mark Gojani**

Saranda është një vend i bukur bregdetar në jug të Shqipërisë. Përveç klimës së ngrohtë dhe plazheve të bukura në afërsi të këtij qyteti, rajoni ka shumë monumente nga koha antike.

Ne e zgjodhëm pikërisht këtë vend për një ekskursion edukativo-arsimor treditör.

U nisëm në pasditen e së enjtes, të fundjavës së fundit të majit, pas përfundimit të mësimit dhe bëmë një rrugë të gjatë mbi dhjetë orëshe, natyrisht me pushime të shkurtëra. Në Sarandë arritëm në orët e vona të mbrëmjes. Pasi pushuam atë natë, të nesërmen paradite e mbajtëm një seancë në të cilën drejtori Walter Happel SJ e bëri një retrospektivë të vitit shkollor 2011/12 para se ai të përfundonte. Pastaj ia mësyëm Feniqit, një lokalitet antik, 10 km larg Sarandës, i cili ende nuk ishte hulumtuar sa duhet. Në kthim e vizituam edhe manastirin e vjetër të Mesopotamit në afërsi të të cilit më pastaj përgatitëm një drekë me mish nga skara. Pas kthimit në Sarandë kohën e lirë e shfrytëzuam për shëtitje nëpër këtë qytet të bukur bregdetar.

Destinacioni i ardhshëm i së shtunës ishte Butrinti, lokalitet antik shumë interesant, 18 km në jug to Sarandës. Pas vizitës së çdo pjese të këtij lokaliteti, amfiteatrit, kalasë e mbetjeve tjera nga shekujt e parë të erës së re, u kthyem në Sarandë për një pasdite dhe mbrëmje të lirë. Të nesërmen, pas kaftjallit, u nisëm në drejtim të Vlorës duke vizituar Apolloninë, te Fieri, një lokalitet poashtu antik.

Pjesën tjetër të udhëtimit e shfrytëzuam për një vizitë shtëpisë së Pavarësisë në Vlorë, duke vazhduar më tej për në Prizren, ku arritëm në mbrëmje për t'u përgatitur për ditën e re të mësimit.



## Alphabetum et pronuntiatio Prof. Ramadan H. Ramadani

Flitet se fenikasit të parët përpiluan shembullin e shkrimit alfabetik. Fenikasi Cadmus e solli në Greqi dhe çmohet si zbulues i shkrimit në shek. XVI para Krishtit. Shkrimet greke dhe latine rrjedhin nga alfabeti fenikas.<sup>(Dict. Larousse, Paris, 1916, f.315)</sup>

Alphabetum, i - n. al'fa'bét,-i, m., sh. -e, -et, -tërësia e shkronjave të një gjuhe, të renditura sipas një rendi të caktuar.<sup>(FGJSSH)</sup> Kuptimi i fjalës alfabet vjen nga semitët, Azia Perëndimore, fjala e parë alef dhe beta, alfa dhe beta (αλφα-álpha dhe βῆτα-béta). Në përkthim haset edhe si - abëcë-ja - Vargu i shkronjave të vëna në radhë që shërbejnë për të shkruar një gjuhë.

Pa shkrim, vazhdimësia e civilizimit do të ishte e pamundur. Shkrimi mundëson bartjen dhe ruajtjen e përvojës dhe idesë. Zhvillimi i shkrimit ka kaluar nëpër disa etapa.

Më parë ngjarjet tregoheshin përmes vizatimeve:

**shkrimi piktografik**, pictografia, ae f. piktografia, - shkrim me shenja, shkronja vizatimore.

Më pastaj vijnë:

**shkrimi ideografik** shkrimi me shenja të vogla grafike, sistem shkrimi, paraqitja e ideve me shenja që paraqesin objektin (ideografi = idea + grafia).

**logografia** - shkrimi që përdor logogramet. Logogr-mma,-atis n. logogram, shenjë me germë që paraqet fjalën.

**shkrimi silabik** - rrokjesor.

**shkrimi ortografik** - drejtshkrimor (mënyra e drejtshkrimit të fjalëve të një gjuhe).

Por, me ardhjen në shprehje të të pëdorurit të alfabetit, ngjarjet dhe gjërat përshkruhen e përcillen, barten te brezat tjerë. Këtu vërehet rëndësia e alfabetit si sistem i thjeshtë dhe i qartë.

Latinishtja që e ndikuar nga shumë gjuhë, sidomos nga greqishtja. P.sh. fjala latine **vates** vjen nga etrusishtja, ndërsa fjala **poeta** nga greqishtja, fjalët **praenomen**, **nomen**, **cognomen**, janë me burim etrusk.<sup>(E. Sedaj, Tekste latine, Prishtinë, 1999, f.11)</sup> Në alfabetin latin mbesin disa nga shkronjat greke që janë si dëshmi për ndikimin e gjuhës greke në atë latine. P.sh.shkronjat **y**, **z**, **th**, **ph**, **ch**, që zakonisht hasen te fjalët e huazuara me prejardhje greke, si p.sh. Athénae, philosophia, etj.

**K** - haset në fjalë greke; **L** - po ashtu; **z** (dz), **x** (ks) si bashkëtingëllore të dyfishta përdoren në fjalët e burimit grek. **Scriptio plena** njihet si alfabeti i parë ku secila **fonemë** (njësi më e vogël e sistemit tingullor të një gjuhe) ka një **grafemë** (shkronjë).<sup>(idem, f. 14)</sup> Alfabeti grek



është që nga shek. VII para Krishtit. Alfabeti latin u përpilua dhe u përshtat nga ai grek.

**Alfabeti latin ka 24 shkronja:**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | B | C | D | E | F | G | H | I | K | L | M | N | O | P | Q | R | S | T | U | V | X | Y | Z |
| a | b | c | d | e | f | g | h | i | k | l | m | n | o | p | q | r | s | t | u | v | x | y | z |

Në fillim ky alfabet kishte 21 shkronja, por më vonë romakët shtuan edhe shkronjat **Y** dhe **Z**. Në mesjetë i shtohet **u**. Për **u** dhe **v** romakët kishin vetëm një shkronjë **v**, p.sh. vva = uva.<sup>(Gortan, Gorski, Paush, Elementa Latina, Prishtinë, 1970, f. 101)</sup> Dallimi i shkronjës **c** nga shkronja **g** vjen nga ndikimi grek. Romakët më parë kanë pasur një shenjë për **c** dhe **g** neglego (nec-lego), negotium (nec-otium), më parë në vend të **g** përdorej **c**.

Në fillim përdorehin shkronja të mëdha, nga të cilat më pastaj u formuan shkronja të vogla, që të lexohet më mirë dhe më shpejt. Kështu në rrugën e mëturshme të zhvillimit (përsosjes), alfabeti latin u kompletua. Ky alfabet me të cilin shërbehemi sot, është më i përhapuri në botë.

**Zanoret (vocales)** - të thjeshta: **a, e, i, o, u, (y)**, zanoret janë të gjata kur përmbi kanë shejnen e gjatësisë (˘) p.sh. ā; ndërsa të shkurta kur dallohen me shenjën e shkurtësisë (˘) p.sh. ă.

**Dyzanoret** - gr. dis-dy dhe **phthoggos**-tingull = **diphthoggos**, lat. gramm. **diphthongus**: **ae, ai, au, ei, eu, oe, ui, (yi)**, gjithmonë janë të gjata.

Kur zanoret duhet të shqiptohen veçmas, përmbi vihet (shënohet) shenja e gjatësisë (˘), shkurtësisë (˘) apo shenja e dierezës (¨) p.sh. **aëra, aëra**, shqiptohet **aera, poëta** ose **poëta** shqiptohet **poeta**.

**Bashkëtingëlloret (Consonantes)** e thjeshta janë: **b, c, d, f, g, h, k, l, m, n, p, q, r, s, t, v, x, z**, dhe të dyfishta **x** dhe **z**.

Nën ndikimin e gjuhës gjermane shkronja **s = z** ndërmjet dy zanoreve dhe togu bashkëtingëllor **ls, sm**, dhe **ns**, p.sh.rosa (lexo roza), dosis (dozis); falsus (falzus); neoplasmā (neoplazma); mensura (menzura).<sup>(J.Tomljanović, Dr.V. Frishiq, Latinski, Zagreb, 1980, f. 69)</sup>

**Shqiptimi-Pronuntiatio, -onis**, f. mënyra e të shqiptuarit të një fjale ose tingulli të një gjuhe.

Shqiptimi i tingujve të një gjuhe, dialekti, nxjerr nga goja tingujt që përbëjnë fjalët e një gjuhe.<sup>(Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954)</sup> Shqiptimi ka ndryshuar duke kaluar nëpër shekuj, duke iu përshtatur rregullave të shqiptimit të gjuhës së përditshme të vendeve përkatëse.

## Alphabetum et pronuntiatio

Shqiptimi latin nuk është i vështirë, ka pak rregulla dhe të thjeshta. Në latinisht janë dy lloje shqiptimesh: **klasik** (antik) dhe **tradicional**.

**Shqiptimi klasik** përdorej nga romakët e vjetër, të epokës klasike. Është më i thjeshtë dhe më i lehtë.

**Shqiptimi tradicional** rrjedh nga mesjeta e hershme dhe dallon nga shqiptimi klasik. Është ruajtur dhe përdoret edhe në ditët e sotme.

## Dallimi midis shqiptimit klasik dhe tradicional

|                      |                    |                                                               |
|----------------------|--------------------|---------------------------------------------------------------|
| Shkruhet             | shqiptimi klasik   | shqiptimi tradicional                                         |
| Aegrotus             | ajgrotus (ae = aj) | egrotus (ae = e)                                              |
| Poenā                | pojna (oe = oj)    | pena (oe = e)                                                 |
| Cicero               | Kikero (c = k)     | Cicero (C - para e, i, y, ae, oe, eu)<br>në raste të tjera k) |
| Caesar               | Kajsar             | Cezar                                                         |
| S- ndërmjet vokaleve | (s)                | (z)                                                           |
| Quantum              | kuantum            | kvantum                                                       |
| Pulchra              | pulkhra            | pulhra                                                        |
| Phosphorus           | phosphorus         | fosforus                                                      |
| Scientia             | skientia           | sciencia                                                      |
| Thorax               | thoraks            | toraks                                                        |
| Viscer-lis           | uiskerālis         | viscerālis                                                    |

## Për shqiptimin klasik dhe tradicional të përbashkëta janë

|                                                                                 |                         |
|---------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|
| I - në fillim të fjalës para një zanoreje dhe ndërmjet zanoreve shqiptohet si j |                         |
| p.sh.                                                                           | iām, iugum, maior       |
| Y = i                                                                           | Illŷria - Ilīria        |
| x = ks                                                                          | lux - luks              |
| ngu = ngv                                                                       | sanguis - sangvis       |
| su = sv                                                                         | suāvis - svavis         |
| qu = kv                                                                         | antīquus - antikvus     |
| ch = h                                                                          | pulcher - pulher        |
| ph = f                                                                          | philosophus - filozofus |
| th = t                                                                          | theatrum - teatrum      |


Pra, sipas shqiptimit antik, dyzanoret **ae**, **oe**, shqiptohen **dy** tingujt; c dhe t gjithmonë si **k** dhe **t**; s gjithmonë si **s**, edhe në mes zanoreve.

th = t  
Ti = ci  
Ti = ti

theatrum - teatrum  
para një zanoreje, p.sh. **nātio**  
- kur është e gjatë, p.sh. **totiūs**;  
- pas **s**, **x**, **t**, p.sh. bēstia, Brattia, mixtio;  
- në fjalët greke - Boeōtia, Aegyptius.

**Theksi (Accentus)** - në fjalët dyrrrokëshe theksohet rrokja e parafundit, p.sh. māter. Në fjalët me tri a më shumë rrokje theksi bie në rrokjen e parafundit kur kjo është e gjatë, p.sh. laudābam, (paroksitone), nëse rrokja e parafundit është e shkurtër, theksi bie në rrokjen e tretë prej fundit, p.sh. mēdicus, fābūla (proparoksitone).

Mësimi i gjuhëve të huaja të bën të lumtur. Për mësimin e një gjuhe të huaj duhet mësuar alfabetin e asaj gjuhe. Prandaj, këtë punim dua ta përmbyll me thënien: "Ta mësosh një gjuhë të huaj është sikur ta fitosh edhe një shpirt tjetër". (B.L. Ullman, Charles Henderson, JR, Latin for Americans, New York, 2007, xvi)



## You think English is easy? Prof. Sijeta Braha

- The bandage was **wound** around the **wound**.
- The farm was used to **produce produce**.
- The dump was so full that it had to **refuse** more **refuse**.
- We must **polish** the **Polish** furniture.
- He could **lead** if he would get the **lead** out.
- The soldier decided to **desert** his dessert in the **desert**.
- Since there is no time like the **present**, he thought it was time to **present** the **present**.
- A **bass** was painted on the head of the **bass** drum.
- When shot at, the **dove dove** into the bushes.
- I did not **object** to the **object**.
- The insurance was **invalid** for the **invalid**.
- There was a **row** among the oarsmen about how to **row**.
- They were too **close** to the door to **close** it.
- The buck **does** funny things when the **does** are present.
- A seamstress and a **sewer** fell down into a **sewer** line.
- To help with planting, the farmer taught his **sow** to **sow**.
- The **wind** was too strong to **wind** the sail.
- Upon seeing the **tear** in the painting I shed a **tear**.
- I had to **subject** the **subject** to a series of tests.
- How can I **intimate** this to my most **intimate** friend?

Let's face it – English is a crazy language. There is no egg in eggplant, nor ham in hamburger; neither apple nor pine in pineapple. English muffins weren't invented in England or French fries in France. Sweetmeats are candies while sweetbreads, which aren't sweet, are meat. We take English for granted. But if we explore its paradoxes, we find that quicksand can work slowly, boxing rings are square and a guinea pig is neither from Guinea nor is it a pig.

And why is it that writers write but fingers don't fing, grocers don't groce and hammers don't ham? If the plural of tooth is teeth, why isn't the plural of booth, beeth? One goose, 2 geese. So one moose, 2 meese? One index, 2 indices? Doesn't it seem crazy that you can make amends but not one amend? If you have a bunch of odds and ends and get rid of all but one of them, what do you call it?

If teachers taught, why didn't preachers praught? If a vegetarian eats vegetables, what does a humanitarian eat? Sometimes I think all the English speakers should be committed to an asylum for the verbally insane. In what language do people recite at a play and play at a recital? Ship by truck and send

cargo by ship? Have noses that run and feet that smell?

How can a slim chance and a fat chance be the same, while a wise man and a wise guy are opposites? You have to marvel at the unique lunacy of a language in which your house can burn up as it burns down, in which you fill in a form by filling it out and in which, an alarm goes off by going on.

English was invented by people, not computers, and it reflects the creativity of the human race, which, of course, is not a race at all. That is why, when the stars are out, they are visible, but when the lights are out, they are invisible.

PS.

Why doesn't "Buick" rhyme with "quick"?



# English is a crazy language

There is no EGG in EGGPLANT nor HAM in HAMBURGER; neither APPLE nor PINE in PINEAPPLE. ENGLISH MUFFINS weren't invented in ENGLAND. QUICKSAND can work SLOWLY. BOXING RINGS are SQUARE, and a GUINEA PIG is neither from GUINEA nor is it a PIG. And why is it that WRITERS WRITE but FINGERS DON'T FING, GROCERS don't GROCE and TEACHERS TAUGHT, why didn't PREACHERS PRAUGHT? If a VEGETARIAN eats what does a HUMANITARIAN eat? And do people RECITE at a PLAY and PLAY at a RECITAL? We SHIP BY SHIP. We have NOSES that RUN and FEET that SMELL. We live in a PARKWAY. And how can a SLIM CHANCE and a FAT MAN and a WISE GUY be opposites? In a language in which your HOUSE can BURN while you are BURNING IT OUT, and in which an ALARM goes off by coming Mother's not MOP?

## Haushalt

| Kalenderjahr           | 2005     | 2006     | 2007     | 2008     | 2009      | 2010      | 2011      | 2012*     | 2013*     |
|------------------------|----------|----------|----------|----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Haushalt               | 489.467  | 549.631  | 874.699  | 988.084  | 1.016.105 | 1.145.639 | 1.252.011 | 1.300.000 | 1.350.000 |
| Einnahmen aus Gebühren | 66.050   | 230.960  | 418.362  | 562.345  | 708.781   | 825.407   | 861.072   | 890.000   | 870.000   |
| Ergebnis vor Spenden   | -423.417 | -318.671 | -456.337 | -425.739 | -307.324  | -320.232  | -390.938  | -410.000  | -480.000  |

\* Zahlen geschätzt

## Schüler

| Schuljahr | 2005/06 |    |    | 2006/07 |     |     | 2007/08 |     |     | 2008/09 |     |     | 2009/10 |     |     | 2010/11 |     |     | 2011/12 |     |     | 2012/13 |     |     |
|-----------|---------|----|----|---------|-----|-----|---------|-----|-----|---------|-----|-----|---------|-----|-----|---------|-----|-----|---------|-----|-----|---------|-----|-----|
|           | Σ       | ♀  | ♂  | Σ       | ♀   | ♂   | Σ       | ♀   | ♂   | Σ       | ♀   | ♂   | Σ       | ♀   | ♂   | Σ       | ♀   | ♂   | Σ       | ♀   | ♂   | Σ       | ♀   | ♂   |
| Schüler   |         |    |    |         |     |     |         |     |     |         |     |     |         |     |     |         |     |     |         |     |     |         |     |     |
| – extern  | 135     | 60 | 75 | 236     | 102 | 134 | 375     | 166 | 209 | 411     | 191 | 220 | 394     | 184 | 210 | 399     | 172 | 227 | 457     | 187 | 270 | 511     | 215 | 296 |
| – intern  | 30      | 11 | 19 | 81      | 27  | 54  | 114     | 41  | 73  | 151     | 66  | 85  | 159     | 65  | 94  | 179     | 73  | 106 | 157     | 57  | 100 | 147     | 56  | 91  |
| Gesamt    | 165     | 71 | 94 | 317     | 129 | 188 | 489     | 207 | 282 | 562     | 257 | 305 | 553     | 249 | 304 | 578     | 245 | 333 | 614     | 244 | 370 | 658     | 271 | 387 |

## Mitarbeiter

| Schuljahr  | 2005/06 |    |    | 2006/07 |    |    | 2007/08 |      |    | 2008/09 |      |    | 2009/10 |      |    | 2010/11 |    |    | 2011/12 |    |    | 2012/13 |    |    |
|------------|---------|----|----|---------|----|----|---------|------|----|---------|------|----|---------|------|----|---------|----|----|---------|----|----|---------|----|----|
|            | Σ       | ♀  | ♂  | Σ       | ♀  | ♂  | Σ       | ♀    | ♂  | Σ       | ♀    | ♂  | Σ       | ♀    | ♂  | Σ       | ♀  | ♂  | Σ       | ♀  | ♂  | Σ       | ♀  | ♂  |
| Lehrer     | 13      | 4  | 9  | 21      | 6  | 15 | 30      | 12   | 18 | 35      | 13   | 22 | 37      | 12   | 25 | 37      | 13 | 24 | 39      | 14 | 25 | 40      | 14 | 26 |
| Erzieher   | 5       | 3  | 2  | 6       | 5  | 1  | 7       | 4    | 3  | 9       | 5    | 4  | 10      | 5    | 5  | 10      | 5  | 5  | 8       | 4  | 4  | 8       | 4  | 4  |
| Küche      | 1       | -- | 1  | 1       | -- | 1  | 2       | 1    | 1  | 2       | 1    | 1  | 2       | 1    | 1  | 3       | 1  | 2  | 3       | 1  | 2  | 3       | 1  | 2  |
| Pförtner   | 1       | -- | 1  | 1       | -- | 1  | 2       | --   | 2  | 2       |      | 2  | 2       | --   | 2  | 2       |    | 2  | 2       | -- | 2  | 2       | -- | 2  |
| Verwaltung | 3       | 2  | 1  | 3       | 2  | 1  | 2,5     | 1,5  | 1  | 2,5     | 1,5  | 1  | 2,5     | 1,5  | 1  | 2       | 2  |    | 2       | 2  | -- | 2       | 2  | -- |
| Leitung    | 2       | -- | 2  | 2       | -- | 2  | 2       | --   | 2  | 2       |      | 2  | 2       | --   | 2  | 2       |    | 2  | 2       | -- | 2  | 2       | -- | 2  |
| Gesamt     | 25      | 9  | 16 | 34      | 13 | 21 | 45,5    | 18,5 | 27 | 53,5    | 19,5 | 31 | 55,5    | 19,5 | 36 | 56      | 22 | 34 | 56      | 21 | 35 | 57      | 21 | 36 |

## Buxheti

| Viti kalendarik            | 2005     | 2006     | 2007     | 2008     | 2009      | 2010      | 2011      | 2012*     | 2013*     |
|----------------------------|----------|----------|----------|----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Buxheti                    | 489.467  | 549.631  | 874.699  | 988.084  | 1.016.105 | 1.145.639 | 1.252.011 | 1.300.000 | 1.350.000 |
| Të ardhurat nga tarifa     | 66.050   | 230.960  | 418.362  | 562.345  | 708.781   | 825.407   | 861.072   | 890.000   | 870.000   |
| Rezultati para donacioneve | -423.417 | -318.671 | -456.337 | -425.739 | -307.324  | -320.232  | -390.938  | -410.000  | -480.000  |

\* Vlerësimi

## Nxënësit

| Viti shkollor | 2005/06 |    |    | 2006/07 |     |     | 2007/08 |     |     | 2008/09 |     |     | 2009/10 |     |     | 2010/11 |     |     | 2011/12 |     |     | 2012/13 |     |     |
|---------------|---------|----|----|---------|-----|-----|---------|-----|-----|---------|-----|-----|---------|-----|-----|---------|-----|-----|---------|-----|-----|---------|-----|-----|
|               | Σ       | ♀  | ♂  | Σ       | ♀   | ♂   | Σ       | ♀   | ♂   | Σ       | ♀   | ♂   | Σ       | ♀   | ♂   | Σ       | ♀   | ♂   | Σ       | ♀   | ♂   | Σ       | ♀   | ♂   |
| Nxënësit      |         |    |    |         |     |     |         |     |     |         |     |     |         |     |     |         |     |     |         |     |     |         |     |     |
| - Të jashtëm  | 135     | 60 | 75 | 236     | 102 | 134 | 375     | 166 | 209 | 411     | 191 | 220 | 394     | 184 | 210 | 399     | 172 | 227 | 457     | 187 | 270 | 511     | 215 | 296 |
| - Konviktorë  | 30      | 11 | 19 | 81      | 27  | 54  | 114     | 41  | 73  | 151     | 66  | 85  | 159     | 65  | 94  | 179     | 73  | 106 | 157     | 57  | 100 | 147     | 56  | 91  |
| Gjithsej      | 165     | 71 | 94 | 317     | 129 | 188 | 489     | 207 | 282 | 562     | 257 | 305 | 553     | 249 | 304 | 578     | 245 | 333 | 614     | 244 | 370 | 658     | 271 | 387 |

## Bashkëpunëtorët

| Viti shkollor | 2005/06 |    |    | 2006/07 |    |    | 2007/08 |      |    | 2008/09 |      |    | 2009/10 |      |    | 2010/11 |    |    | 2011/12 |    |    | 2012/13 |    |    |
|---------------|---------|----|----|---------|----|----|---------|------|----|---------|------|----|---------|------|----|---------|----|----|---------|----|----|---------|----|----|
|               | Σ       | ♀  | ♂  | Σ       | ♀  | ♂  | Σ       | ♀    | ♂  | Σ       | ♀    | ♂  | Σ       | ♀    | ♂  | Σ       | ♀  | ♂  | Σ       | ♀  | ♂  | Σ       | ♀  | ♂  |
| Mësuesit      | 13      | 4  | 9  | 21      | 6  | 15 | 30      | 12   | 18 | 35      | 13   | 22 | 37      | 12   | 25 | 37      | 13 | 24 | 39      | 14 | 25 | 40      | 14 | 26 |
| Edukatorët    | 5       | 3  | 2  | 6       | 5  | 1  | 7       | 4    | 3  | 9       | 5    | 4  | 10      | 5    | 5  | 10      | 5  | 5  | 8       | 4  | 4  | 8       | 4  | 4  |
| Kuzhina       | 1       | -- | 1  | 1       | -- | 1  | 2       | 1    | 1  | 2       | 1    | 1  | 2       | 1    | 1  | 3       | 1  | 2  | 3       | 1  | 2  | 3       | 1  | 2  |
| Portierët     | 1       | -- | 1  | 1       | -- | 1  | 2       | --   | 2  | 2       |      | 2  | 2       | --   | 2  | 2       |    | 2  | 2       | -- | 2  | 2       | -- | 2  |
| Administrata  | 3       | 2  | 1  | 3       | 2  | 1  | 2,5     | 1,5  | 1  | 2,5     | 1,5  | 1  | 2,5     | 1,5  | 1  | 2       | 2  |    | 2       | 2  | -- | 2       | 2  | -- |
| Udhëheqja     | 2       | -- | 2  | 2       | -- | 2  | 2       | --   | 2  | 2       |      | 2  | 2       | --   | 2  | 2       |    | 2  | 2       | -- | 2  | 2       | -- | 2  |
| Gjithsej      | 25      | 9  | 16 | 34      | 13 | 21 | 45,5    | 18,5 | 27 | 53,5    | 19,5 | 31 | 55,5    | 19,5 | 36 | 56      | 22 | 34 | 56      | 21 | 35 | 57      | 21 | 36 |

## Standardi dhe debatet e sotme rreth tij

### Prof. Xhafer Beqiraj



Debatet për gjuhën standarde shqipe janë të nevojshme dhe të mirëseardhura për zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit dhe të nënsistemeve të saj dhe do t'i shpien përpara kërkimet shkencore, ashtu si ndodh edhe me gjuhët e tjera evropiane e më gjerë. Standardi nuk është një kod i mbyllur, sepse së bashku me zhvillimin e shoqërisë shtrohet nevoja edhe për zhvillimin e mëtejshëm të tij dhe ndryshimet duhet të vijnë natyrshëm, me tolerancë dhe pa politizime. Gjuha standarde është njësisë më e shenjtë mbarëkombëtare me të cilën identifikohem në botë.

Mirëpo debatet e zhvilluara deri më sot për gjuhën standarde nxjerrin në pah qëndrime ndër më të ndryshme për të. Në debatet televizive dhe në mediat e tjera të shkruara kudo ndër ne, është vënë në dukje tendenca e disa prej debatuesve kundër standardit të shqipes. Kush më shumë e kush më pak i veshin standardit ngjyrimet politike, duke thënë se është pjellë e periudhës komuniste, dikush fajëson standardin me pretekstin se kosovarët e kanë të vështirë të zotërojnë atë në praktikë, disa të tjerë marrin guximin të kërkojnë një standard për Kosovën dhe kështu të krijohet një identitet i ri, ka debatues, të cilët kërkojnë ngritjen e një standardi me bazë gegërishten. Po ashtu janë shprehur mendime, duke e fajësuar standardin e shqipes, se fëmijët të cilët flasin gegërishten në familje e kanë të vështirë ta zotërojnë shqipen e unisuar, kurse fëmijët, të cilët e flasin toskërishten në familje e kanë më të lehtë ta zotërojnë atë, sepse është më afër këtij dialekti të shqipes etj. Në këtë pikë, një dukuri e tillë është e vërtetë, por kjo ndodh edhe në gjuhë të tjera e megjithatë standardet e tyre vazhdojnë me hov të zhvillohen.

Idetë e dala nga këto debate, na duken sa të habitshme, po aq edhe të papritura për gjuhën e unisuar shqipe, e cila qe ëndërr dhe dëshirë e shumë patriotëve dhe dijetarëve ndër shekuj, të cilët luftuan që kombi shqiptar ta ketë një gjuhë të unisuar.

Qëndrimet e tilla për gjuhën standarde sot janë ogurzeza për mbarë kombin shqiptar dhe nëse nisemi nga kjo logjikë, do të krijohet një hendek i thellë brendapërbrenda tij. Mirëpo shqipja e unisuar ka shuar shtatë dekadat e fundit dhe qëllimet për ta zëvendësuar atë do të jenë dështake, sepse mendjet e ndritura ndër shqiptarë, qenë çdoherë pararojë e gjuhës, e kulturës shqiptare dhe faktorë unifikues. Një gjë të tillë e bënë edhe kosovarët në vitin 1968 në Prishtinë, kur u mbajt Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, të




cilët në shenjë përkrahjeje të gjuhës së unisuar shqipe dolën me qëndrimin "një komb – një gjuhë" dhe kështu i paraprinë zhvillimit historik të Kongresit të Drejtshkrimit më 1972.

Për t'i kontestuar të gjitha këto qëndrime destruktive dhe hipoteza të pabaza kundër gjuhës standarde shqipe, do të tërheqim një paralele në mes të shqipes dhe gjermanishtes. Gjermanishtja, siç dihet, është një gjuhë me shumë dialekte dhe dallimet në mes të dialekteve dhe nëndialekteve të saj, janë shumë më të mëdha sesa dallimet që ekzistojnë në mes dy dialekteve të shqipes. Gjuhën gjermane e flasin mbi 100 milionë gjerman folës në disa shtete. Nëse shikojmë historinë e zhvillimit të gjermanishtes ndër shekuj, do të vërejmë se gjatë formimit të standardit të saj ka pasur mjaft vështirësi, si edhe në shqipet, duke filluar që nga Martin Luteri, Bismarku e këndej. Natyrisht se pati mospajtime dhe pakënaqësi ndër gjermanofonë për krijimin e standardit, mirëpo të gjitha i tejkaluan dhe gjuha gjermane vazhdoi rrugëtimin e saj të zhvillimit. Ajo sot është ndër dhjetë gjuhët më të rëndësishme në botë, është gjuhë e kulturës, e shkencës dhe e teknologjisë. Shtrohet pyetja – a kanë probleme sot gjermanofonët me standardin? A hasin në vështirësi fëmijët në nxënien e gjuhës standarde në këto vende? A e përdorin në familje dialektin? A zotërohet në nivel të duhur standardi në këto hapësira sot?

Po të hulumtojmë nëpër forume të ndryshme në internet, do të shohim se në këto vende, ku flitet gjermanishtja, problemet janë shumë më të mëdha, sesa te ne shqiptarët. Dialektet e gjermanishtes janë aq larg njëri-tjetrit sa folësit e dialekteve të ndryshme e kanë të vështirë të merren vesh njëri me tjetrin, kurse ndër ne pa vështirësi komunikojnë toskë dhe gegë, sepse dialektet e shqipes janë shumë afër njëri-tjetrit.

Fëmijët, në këto vende gjermanofone, në familje mësojnë dialektin, kurse në shkollë e mësojnë standardin, dmth. ashtu siç ndodh edhe me fëmijët tanë, të cilët në familje flasin në dialekt, kurse në shkollë mundohen të mësojnë gjuhën standarde.

Kur kemi parasysh gjermanishten dhe kur dimë se ajo ka filluar të lëvrohet shumë herët para shqipes, kur vlen një standard për disa shtete me dhjetëra milionë gjermanofonë, dhe kur dihet se probleme kanë edhe ata me



## Schule

### Standardi dhe debatet e sotme rreth tij

zotërimin e standardit. Shtrohet pyetja – pse bëjmë kaq shumë zhurmë kundër standardit, pse nuk mendojmë si një komb, ashtu si gjermanët?

Ne mendojmë se nuk kemi kohë për të humbur, pra nuk mund të kthehemi në vitin 1972, sepse ashtu-ashtu qemë të fundit në Evropë që bëmë standardizimin e gjuhës. Jemi një popull i vogël dhe nuk duhet të ndahemi furka-furka për shkak të tekeve të dikujt që vjellin helm e vrer kundër gjuhës së përbashkët, të cilën e ngritëm me shumë mund dhe sakrificë. As nuk duhet veshur me ngjyrimet politike standardin e sotëm, sepse të gjitha gjuhët e standardizuara janë krijuar në epoka dhe rrethana të caktuara politike, sociale e administrative. Nëse shkohet me këtë logjikë, atëherë edhe gjermanët duhet ta hedhin poshtë standardin e tyre, sepse ky standard u ngrit në kohën e Bismarkut dhe banorët e Hanoverit qenë të privilegjuar, për shkak se dialekti i tyre u ngrit në standard. Por, gjermanët ndjekin tjetër logjikë, ata luftojnë për zhvillimin e mëtutjeshëm të gjuhës dhe kështu e ruajnë dhe e forcojnë statusin e gjuhës së tyre, e cila është ndër gjuhët më të zhvilluara në botë.

Në të përfunduar të këtij vështrimi po shtojmë se standardi nuk është i paprekshëm, ai mund të pësojë ndryshime në nënsisteme, por duke pasur kujdes gjithnjë e përhersa në mos lëndimin e tij.

## Shkolla

### Detyra të zgjidhura në matematikë Prof. Faton Kabashi



"Detyra të zgjidhura në Matematikë" është libri i botuar nga mësimdhënësi i shkollës sonë Faton Kabashi, në prill të vitit 2012. Libri ka më shumë se 500 faqe, ku janë paraqitur rreth 1000 detyra e probleme të zgjidhura. Libri është ndarë në 10 kapituj, kurse çdo kapitull është i ndarë në paragrafet përkatëse. Në hyrje të çdo kapitulli është paraqitur një përmbledhje e shkurtër me njohuri teorike, që shfrytëzohet si për zgjidhjen e detyrave të paragrafit, ashtu edhe për të freskuar njohuritë e domosdoshme që janë shfrytëzuar për zgjidhjen e detyrave.

Pas njohurive teorike pasojnë "Detyra të zgjidhura", të cilat janë të zgjidhura detajisht dhe në mënyrë të plotë, duke dhënë sqarime të duhura. Çdo kapitull përfundon me paragrafin "Detyra për punë të pavarur", ku jepet një numër i konsiderueshëm detyrash, në mënyrë që nxënësi të vazhdojë punën e vet të pavarur në zgjidhjen e tyre.

Ky libër mund të përdoret nga të gjithë nxënësit e shkollës së mesme, nga maturantët për përgatitjen e provimit të maturës. Poashtu, libri mund të jetë një ndihmesë e madhe për të gjithë studentët e vitit të parë të cilët e kanë në program lëndën e matematikës elementare.



## Vizita në Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit Lirjeta Gruda – VIII b



Prizreni është qytet i lashtë. Në këtë qytet është ndërtuar edhe shkolla jonë Loyola-Gymnasium ku ka nxënës shumë të talentuar dhe gazmorë. Ne, si klasë, u organizuam që të vizitonim vendet më interesante të këtij qyteti, Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Kalanë e njohur të këtij qyteti.

Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit qe vendi ku ne vendosëm të mblidheshim së bashku. Ishte ora 13:00 kur ne hymë brenda shtëpisë së lashtë të Lidhjes së Prizrenit. Shkalët ishin prej druri dhe shumë të ngushta, mu si në kohët e lashta. Më lanë përshtypje pikturat dhe bustet e pjesëmarrësve- të gjithë me fytyra të ngrysur. Kjo tregon se ngjarjet e rëndësishme kërkojnë seriozitet të pjesëmarrësve, të gats-hëm që edhe jetët e tyre t'i jepnin, por kurrë të mos ua lëshonin trojet shqiptare armiqve.

Pak më vonë dëgjuam nga ciceroni se megjithë këmbëngulësinë e Ymer Prizrenit, Mic Sokolit e të tjerëve, për trojet shqiptare kanë vendosur Fuqitë e Mëdha, të cilat qenë pajtuar që disa troje t'i takonin Maqedonisë, disa Serbisë e Malit të Zi. Secili nga ne i dëgjonte me vëmendje këto të dhëna, dhe thosha me vete se duhet ta ndryshojmë këtë gjë, që të punojmë dhe të vendosim vetë për fatin dhe të ardhmen tonë.

Pastaj pamë veshjet si pjesë e së kaluarës kulturore dhe traditës së popullit tonë, si tirq, plisin e bardhë, jelekun e kuq e të zi etj. Tutje shikonim dhomat e pritjes së mysafirëve. Shumë lashtësi shihje kur shikoje qilimat e kuq të ndarë pjesë-pjesë në të dy anët e murit të dhomës.



Pas vizitës këtu, shkuaam te Kalaja e Prizrenit. Ishte pjesërisht e rrënuar, por shumë e bukur, me këmbët e saj të ngulura thellë rrëzë malit Sharr. Aty shiheshin disa vende ku ishin strehuar njerëzit e më vonë kishte filluar ndërtimi i qytetit poshtë Kalasë. Ato vende dukeshin si shpella të vogla, e jo si shtëpi, por të ndërtuara nga duart e vyerat të shqiptarëve në kohërat e lashta, për mbrojtjen nga pushtuesit e kohës.

Nga lart shtëpitë dukeshin shumë të vogla, rrugët e ngushta mezi vëreheshin, kurse lumi me pesë urat e tij dallohej më qartë. Kjo ishte vizita jonë në Kala dhe te Lidhja e Prizrenit. Duke zbritur poshtë bisedonim për fillimin e vitit të ri shkollor. Kujdestari ynë, Maksut Pirku, na këshillonte e na tregonte për rregullat e shkollës që nuk duhet shkelur në asnjë mënyrë. Pasi zbritëm në qytet, u shpërndamë nëpër shtëpitë tona shumë të kënaqur dhe të relaksuar, me shumë vullnet për punë dhe mësim në ditët që do të vijnë.



## Schule

19 – 22 prill 2012

KAS-Seminar me nxënësit nga Prishtina dhe Maqedonia  
Gresa Kabashi – XII b

Kjo ishte data e fillimit të seminarit, i cili tani është shndërruar në një përvojë të paharrueshme për të gjithë ne. Ka kaluar vetëm pak kohë nga përfundimi i tij dhe ne kemi filluar të ndiejmë mungesën e njëri-tjetrit, ndonëse ky seminar ka zgjatur vetëm katër ditë. Brenda një kohe kaq të shkurtër ne kemi arritur të krijojmë një afërsi aq të madhe mes nesh, sa që për shumëkë kjo mund të duket e çuditshme. Por për ne jo.

Gjatë këtyre katër ditëve, ne jo vetëm që kemi qenë së bashku gjatë seminarit, por kemi qëndruar me njëri-tjetrin edhe gjatë kohës që nuk zhvillohej seminari. Kemi ngrënë së bashku, kemi luajtur, kemi vallëzuar, kemi shikuar filma, kemi diskutuar, jemi njohur, kemi vizituar qytetin e kështu me radhë. Dhe, kanë qenë pikërisht këto aktivitete që kanë bërë që ne të afrohemi më shumë me njëri-tjetrin. Rol të madh në njohjen tonë ka luajtur edhe seminari, i cili është zhvilluar në formë loje, me qëllim që të mos bëhej i bezdisshëm dhe ne t'i kuptonim më mirë punën dhe detyrat e Bashkimit Evropian, që në fakt ishte temë kryesore e seminarit tonë.

Gjatë lojës ne ishim të ndarë në disa grupe, ku secili grup kishte detyrat e tij. Grupi i parë i takonte përfaqësuesve të Komisionit Evropian, grupi i dytë përbëhej nga përfaqësuesit e vendeve anëtare të Këshillit Evropian, grupi i tretë i takonte përfaqësuesve të këtyre vendeve në Parlament, grupi i katërt ishin përfaqësuesit e pesë vendeve që kishin bërë kërkesë për anëtarësim në Bashkimin Evropian (Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia) dhe grupi i pestë, jo më pak i rëndësishëm se të tjerët, ishin mediat.

Gjatë seminarit ne kishim emra të tjerë, në bazë të vendeve që përfaqësonim, në mënyrë që të kuptonim më mirë qëllimin e lojës. Meqenëse gjatë gjithë kohës kishim diçka për të bërë, koha kalonte shumë shpejt. Sa hap e mbyll sytë kalendari shënoi datën 22 prill, datën e përfundimit të seminarit. Në mëngjesin e kësaj dite, ne u përshëndetëm me miqtë tanë të rinj, me shpresën që ditë të tilla do të vinin përsëri.



## Shkolla

English lesson  
Valon Mustafa – XI b

A lot of students think that an English lesson may be boring and very uninteresting. But this fact isn't true for our class. Our English teacher, Sijeta Braha, is a very creative teacher who has always good ideas to make the lesson funnier and more interesting, in a strict and disciplined way.

At least once a week, we make projects, presentations or play games to learn English while having fun. For example, one day we looked in our book and read about different gadgets like inflatable speakers, Walkie-Talkie-Watches and many other interesting things. Then our teacher had an idea, and told us to take a gadget from home to school for the next lesson. We had to form groups and make advertisements for the different gadgets. Each group presented their product to the other groups trying to "sell" as many as they can. One of them sold a phone with different functions, another group was very imaginative and took a normal barrette and told it was a spy tool with a built in camera and a microphone to see and to listen to other people. So it wasn't so necessary to take a real gadget and tell something about it, it was more important to know how to present it.

It was like a big market, where everyone tried to sell his own product and tell the customer how good it is etc. It was a very funny lesson, in which we could learn everyday English, repeat the last lessons and play a funny game at the same time. So we were relaxed for the next lesson and were more concentrated.

I think every other lesson or at least a language lesson should be like the English lessons we have.



## Një vit përplot aktivitete sportive Prof. Liridona Krasniqi & Prof. Mentor Ukimeri



Në fillim të vitit u organizua një turne në basketboll dhe futboll për meshkuj, me ç'rast u dalluan nxënësit e klasës XI a.

Për nder të 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit, shkolla jonë organizoi një turne në volejboll, ku pjesëmarrja ishte e përzier, djem dhe vajza së bashku, ku më të mirët ishin nxënësit e klasës XII a.

Të shtuneve, të gjithë, të prirë nga edukatorët tanë organizojmë ndonjë ndihmë rreth konvikteve dhe shkollës. Secili edukator me grupin e tij merr përgjegjësi për "territorin" e caktuar që të rregullohet. Kjo është punë e frytshme dhe argëtuese, gjithashtu, sepse në fund shikon rezultatin e kontributit tënd, në rrethin ku ti je pjesë e tij.

Sporti është një aktivitet i rëndësishëm në konvikt. Ne organizojmë turne të ndryshme, ku marrin pjesë vajzat dhe djemtë. Gjatë zhvillimit të lojërave jemi në tension të përzier me emocione. Secili ekip mundohet të japë maksimumin dhe të arrijë fitoren, por jo secili është fitues. Ekipet që fitojnë shpërblehen, kurse ata që nuk janë pjesë e fituesve, thjesht kënaqen dhe argëtohen gjatë zhvillimit të lojës.

Vend të konsiderueshëm në konvikt zë edhe kinemaja. Çdo të premte, kur ne qëndrojmë në konvikt, në mbrëmje organizojmë shfaqje të ndonjë filmi. Filmat i përzgjedhim ne. Këta filma janë me tematikë të ndryshme, si p.sh. komedi, romançë, aksion dhe filma të animuar e edukativ. Kjo mbrëmje pritet me padurim dhe plot entuziazëm, sepse pas shfaqjes pastaj kemi diskutime të përbashkëta rreth temës së filmit si dhe mesazhi që përcjellë ngjarja e shtjelluar.

Pjesë e pandashme, përveç filmave, janë edhe pikat teatrale të cilat shumë shpesh i ushtrojmë. Këto pjesëza më pas i paraqesim para nxënësve të tjerë gjatë programeve që orga-

nizohen për festa të ndryshme. Tema e këtyre pikave është më së shumti edukative, si dhe pjesë komike.

Vallëzimi është njëri ndër hobet më të pëlqyera nga ne. Me ndihmën e edukatorëve arrijmë të organizojmë vallëzime mbresëlënëse. Këto vallëzime i paraqesim poashtu gjatë programeve që i organizojmë në konvikt.

Ndër ditët që ne i presim me padurim është edhe festa e themelimit të shkollës – 16 Prilli. Në konvikte festa fillon qysh me përgatitjet paraprake, ndërsa një program modest shfaqet një ditë më parë, në mbrëmje. Programi ynë kishte pika të ndryshme të organizuara nga ne nxënësit, duke mos harruar kontributin e madh të edukatorëve, të cilët japin maksimumin duke na përkrahur dhe mbështetur pamasë.

Në këtë program u paraqitën të gjitha vallëzimet, pjesët teatrale e shumë e shumë aktivitete tjera.

Pra, jeta në konvikt nuk është aspak monotone dhe e mbyllur. Ajo, përkundrazi, është një jetë ku krijojmë një familje të re e të madhe. Ne jetojmë një jetë që ia jep secilit mundësinë ta njohë më mirë vetveten, dhe papritur, një ditë e shohim veten krejtësisht ndryshe, më të rritur, më të pjekur, thënë me një fjalë – më të kompletuar.



## Internat

### Turneu në shah – nxënësi Ylber Roka më i miri Arianit Çollaku

Shahu si sport më vete zgjon në masë të madhe inteligjencën dhe e vë në lëvizje gjithë memorien e sportistit. Duke e parë interesimin e madh të nxënësve konviktore dhe aftësitë për lojën e shahut, e kemi parë të arsyeshme që ta organizojmë një turne apo garë në këtë lojë të bukur.

Dhe, si gjithmonë, interesimi i nxënësve ishte shumë i madh dhe për këtë arsye sistemi i garës ka qenë me eliminim direkt. Gara ka zgjatur më shumë se një muaj. Të luash shah do të thotë të kesh aftësi organizimi dhe planifikimi të strategjive, të jesh i zgjuar në çdo moment.

Këtë e dëshmuar nxënësit tanë që me të vërtetë janë të zgjuar dhe të aftë për planifikime, me një fjalë, janë në rrugën e drejtë të zhvillimit kulturor e edukativ. Pas shumë e shumë lojërash të bukura e eliminimit të kandidatëve me radhë, si gjithmonë në finale mbërrijnë më të mirët, e më të mirët në këtë garë ishin nxënësi Ylber Roka, i grupit IV dhe Rilind Geci, i grupit V. Në ballafaqimin në mes këtyre finalistëve, me plot meritë kampion doli nxënësi Ylber Roka .

Edhe në këtë sport u vërejt një sjellje shumë e mirë e nxënësve, me ç'rast dua të falënderoj shumë të gjithë pjesëmarrësit dhe t'ju dëshiroj suksese edhe në gara tjera.



## Konvikt

### Turneu në pingpong ndiqet me interes nga nxënësit Arianit Çollaku

Në muajin janar të këtij viti, në konvikt ishte për vizitë Patër Kristianin nga Polonia, një aktivist dhe punëtor i palodhur. Me të patëm rast që të organizonim disa aktivitete në konvikt. Një ndër këto aktivitete, që ishte ndër më të mirët, ishte turneu në pingpong.

Duke parë kohën e ftohtë dhe dëborën që na kishte pamundësuar zhvillimin e aktiviteteve në ambientet e jashtme sportive, vendosëm të organizonim një turne në pingpong. Interesimi i nxënësve për pjesëmarrje ishte shumë i madh dhe për këtë arsye turneu zgjati plot një muaj.

Që turneu të ishte më interesant vendosëm që sistemin garues ta bënim jo me eliminim direkt, por me grumbullim të pikëve. Mund të them që tërë munda për organizimin e këtij turnue u dëshmuar të ishte me vlerë, sepse nxënësit treguan një sjellje tejet sportive, edukatë dhe respekt të mirë.

Pas shumë lojërash e grumbullimit të pikëve, në fund ishin katër nxënës që arritën të mbërrinin në finale, e këta janë: Hysen Hoti, gr. II, Valon Përvorfi, gr. III, Gazmend Fazliu, gr. IV dhe Ilir Përvorfi, gr. V. Dhe, si gjithmonë, fundi ishte shumë i "nxehtë", ku në finale u takuan më të fortit. Pas takimeve e lojërave të bukura, në fund fitues me plot meritë doli Valon Përvorfi.

Ishte kënaqësi shumë e madhe për mua që ta organizoja një aktivitet të tillë dhe shpresoj që edhe në të ardhmen në konvikt përsëri do të ketë aktivitete të tilla.



## Internat

### Bora në Loyola-Gymnasium Arbnora Duhanaj – X c



Ishte natë. Të gjithë ndodheshim brenda në konvikt. Disa ishin duke mësuar e disa të tjerë rrinin buzë dritareve, duke e shikuar qiellin e bukur dhe borën e cila veç sa kishte filluar ta mbulonte tokën. Ishte pamje madhështore.

Në mëngjes u zgjova dhe hapa dritaren të shihja se sa borë kishte rënë. Kishte rënë aq sa për të luajtur me shoqërinë time. Mezi prisja që të dilja jashtë për ta shijuar atë bukuri të natyrës. Pas mësimit të gjithë kishin dalë për të luajtur me topa bore; të gjithë loznim dhe dëfreheshim me atë borë të ftohtë, por që ne na dukej shumë e ngrohtë, sepse ishin dashuria dhe miqësia ato që mbizotëronin atë ditë dhe e mundnin të ftohtët e dimrit.

Sa herë e kujtoj këtë ditë, në fytyrën time shfaqet një buzëqeshje e vogël, por që për mua do të thotë shumë. Ishte viti i parë që unë e kisha parë oborrin e Loyola-Gymnasium-s të mbuluar me borë, dhe me të vërtetë ishte bukur. Atë ditë bora nuk kishte të ndalur, binte lehtë-lehtë në gërshetat e vajzave të cilat po loznin me njëra-tjetrën. Ishte kënaqësi t'i përjetoje ato momente.

Edhe pse dimri është i mërzitshëm dhe i ftohtë, atë ditë për ne ishte tepër gazmor. Të qeshurat tona arrinin deri në qiell dhe, po të më thoshte dikush se do të gëzohesha aq shumë, nuk do ta besoja, mirëpo pasi që e përjetova edhe vetë, nuk do ta harroj asnjëherë atë ditë e cila më ka lënë mbresa të mëdha.



## Konvikt

### Kinemaja në konvikt Fjolla Gashi – XI c


Mesazhi të cilin e marrim pas çdo libri të lexuar me të vërtetë është i vlefshëm dhe na nevojitet në jetë. Ajo të cilën e mësojmë nga filmat e ka një përparësi tjetër- atë mund ta shohim.

Ne e organizuam një grup nën udhëheqjen e edukatores Filomena për dy arsye, që ta pasurojmë kinemanë me filma me mesazhe të ndryshme dhe të mund ta kalojmë më mirë kohën e lirë në konvikt.

Nxënësit i panë lajmërimet për filmin e parë "The social network" ndërsa në orën 19:15 një numër i madh i tyre erdhën në sallën e filmit. Shikuesit kishin për detyrë të jepnin nënshkrimet që tregonin praninë e tyre. Filmi i cili pati shikueshmëri më të madhe ishte "The next three days" i cili shtjellon një problem që ka të bëjë me një çështje familjare.

Ata të cilët bënëin përzgjedhjen e filmave janë: Albulena Hoti, Vjollca Morina, Fisnik Hajredini, Fatjon Ademaj, Nol Gjergjaj dhe Miftar Golaj.

Shpresojmë që edhe këtë vit do të vazhdojmë me hapa të njëjtë, sepse me të vërtetë ishte një përvojë e bukur.



## Internat

### Kompromisi dhe solidariteti në shkollën tonë Daniell Allakaj – VII a

Është vështirë të shkruaj për këtë shkollë të ëndrrave të mia dhe të gjithë nxënësve të cilët kanë dëshira për të pasur sukses në të gjitha gjërat që të sigurojnë ardhmëri të ndritur, por kjo nuk bëhet pa punë e pa përpjekje. Pra për të pasur sukses, unë zgjodha Loyola-Gymnasium. Është një nga shkollat më të disiplinuar në Kosovë për të cilën më së shumti është munduar P. Happel. Në Loyola-Gymnasium i kemi edukatorët tanë, të cilët na edukojnë dhe na mësojnë për shumë gjëra dhe për shumë sfida të reja për jetë. Ata na japin lumturi, dashuri dhe më të mirën buzëqeshje.

Në konviktin tonë organizojmë lojëra në shumë sporte, por çka është më e rëndësishmja për njeriun dhe për shoqërinë, ne jemi si individë dhe si shoqëri shumë solidarë, kjo do të thotë se ne e ndihmojmë njëri-tjetrin në detyra dhe e përkrahim, të dobëtit i japim kurajo etj. Shumë nga ne shpesh mendojmë se kur një shoqëri ka mosmarrëveshje, njëra anë duhet të fitojë, ndërsa tjetra duhet të humbë, por këtu në shoqërinë tonë shumë të re kemi mësuar dhe jemi duke e praktikuar vlerën e kompromisit. Ne mundohemi të jemi ata ku secila palë mund të jetë fitues duke dëgjuar pikëpamjet e njëri-tjetrit. Kjo është e rëndësishme kur kemi parasysh faktin se njeriu është një qenie shoqërore që jo gjithmonë arrin të bjerë dakord me të gjithë njerëzit, sidomos me ata që jeton dhe punon, e konkretisht ne që jemi si nxënës më të vegjël.

#### Faleminderit të gjithëve!

Për këtë gjë më së shumti meritojnë falënderim prindërit që na kanë mundësuar ardhjen në këtë shkollë, por edhe edukatorët të cilët na përkrahin në çdo aspekt-në kompromis dhe solidaritet.



## Konvikt

### Turne në futboll i vajzave Edona Ukaj – XII c

Njëra nga aktivitetet që shpeshherë mungon në shoqërinë tonë, e që ne kemi mundësinë ta përjetojmë, është turneu në futboll i vajzave. Këtë vit për herë të parë nga edukatorët tanë u organizua një turne i tillë.

Në këtë turne morën pjesë tri grupe të vajzave. Edhe unë, si shumë vajza tjera, kisha mundësi të isha pjesë e ekipit të grupit tonë. Pas një loje të shkëlqyer që treguam në finale, ne, grupi nr. VIII "Fluturat", u shpallëm kampionë në këtë turne dhe fituam kupën.

Gjithçka ishte e mrekullueshme. Në çdo pjesë të fushës mund të shihje entuziazmin e shokëve dhe shoqeve tona. Me të vërtetë ishte një natë e paharruar, saqë për një moment u ndjeva sikur të isha në një nga ato finalet e mëdha të Ligës së Kampionëve.



## Internat

### Loyola-Gymnasium – një vend i mundësive për aktorët e rinj Ed. Frrok Thaçi



Në fillim të këtij viti shkollor nxënësit konviktorë që kanë prirje për aktrim janë bashkuar në një takim pune. Ky takim u udhëhoq nga unë, ndërsa asistentë nga të pranishmit u zgjodhën nxënësit Nikë Raja dhe Marigona Berisha.

Për mua si edukator është kënaqësi të punoj me këta nxënës, të cilët kanë vërtet prirje për aktrim dhe për një kohë mjaft të shkurtër mund të përgatisin shfaqje të ndryshme.

Gjatë këtij viti kemi paraqitur disa herë shfaqje me tema edukative e kombëtare, ku nuk ka munguar as humori nga të vegjëlit të cilët kanë qenë gjithnjë e më tepër simpatikë. Këta nxënës janë në gjendje që të dalin dhe të improvizojnë pa skenar dhe gjithmonë janë të suksesshëm.

Çdo fëmijë ka talent, mirëpo duhet dikush ta zbulojë këtë talent. Këtë në Loyola-Gymnasium e zbulojnë arsimtarët dhe edukatorët. Interesimi i nxënësve është gjithnjë e më i madh për aktrim, dhe shpresoj se këta nxënës këtu po i thyjnë barrierat dhe po hapin rrugë të reja drejt suksesit. Loyola-Gymnasium është një vend i mundësive.



## Konvikt

### Një mysafir nderi në grupin tonë Arjeta Berisha – XII c

Gjatë kohës së qëndrimit në konvikt, kemi pasur mundësinë të merremi me aktivitete të ndryshme dhe njëra ndër to ka qenë edhe gatimi që është bërë në kuzhinën e shkollës sonë.

Shumë herë kemi përgatitur ushqime të ndryshme, si për pjesëtarët e grupit, ashtu edhe për të gjithë nxënësit e konviktit. Mirëpo këtë herë darka që do të përgatitnim ishte për një mysafir special, i cili nuk kishte darkuar me ne ndonjëherë më parë. Duke biseduar me motrën Klara, shprehëm dëshirën që atë natë darkën ta përgatitnim vetë, pa i shkaktuar fare probleme kuzhinieres sonë. Ne vendosëm që atë natë të kemi një darkë më ndryshe se netëve tjera, darka të servohet në konviktin tonë dhe si mysafir ta ftojme drejtorin e shkollës sonë, P. Happel.

Të gjithëve na pëlqeu ideja dhe pa humbur kohë shkuam në kuzhinë. Ajo që do të përgatitnim nuk ishte diçka e madhe, por ishte shumë e pëlqyer nga ne. Ishte diçka që përgatitej shumë lehtë dhe të gjitha vajzat ishim në gjendje që ta bënim. Ato ishin pallaçinkat që mezi prisnim t'i hanim. Kuzhinierja na përgatiti brumin që na nevojitej. Ishim pesë vajza që me kënaqësi të madhe bënim pallaçinkat. Ia kishim filluar pak vonë dhe çdo çast shikonim orën, sepse frikësoheshim se nuk mund t'i përgatitnim të gjitha deri në orën e caktuar në të cilën e kishim ftuar drejtorin. Në anën tjetër, motra së bashku me disa vajza, po përgatiste tavolinat, pjatat, pijet dhe të gjitha gjërat e nevojshme.

Për ne ishte pak më e vështirë, sepse për dy orë kishim qëndruar në këmbë dhe ishim lodhur paksa. Por, prapëseprapë atë e bënim vetëm për kënaqësinë tonë. Erdhi momenti final ku darka ishte shtruar dhe prisnim mysafirin. Edhe P. Happel erdhi. Me vete solli edhe disa çokollata. Ne e mirëpritëm dhe e falënderuam që kishte pranuar ftesën tonë. Të gjithë filluam të hanim dhe ai na tha se pallaçinkat ishin shumë të shijshme dhe po i pëlqenin. Me të vërtetë edhe ne na u bë qejfi. Kaluam një kohë duke bashkëbiseduar dhe duke qeshur të gjithë së bashku.

Darka përfundoi dhe P. Happel na falënderoi shumë që e kishim ftuar dhe që ia ofruam mundësinë që e kishim që të ketë një darkë më ndryshe se herave tjera. Pas darkës i rregulluam dhe i pastruam të gjitha gjërat së bashku dhe ishim shumë të gëzuara që çdo gjë shkoi ashtu siç e kishim planifikuar, ndërsa pallaçinkat e përgatitura nga duart tona i pëlqyen shumë drejtorit tonë.



## Internat

### Një mbrëmje në "Luna Park" Aurela Hoti – XI d



Sonte, në konvikt, nuk është një natë e zakonshme. Ne, vajzat e grupit "Sirenat" së bashku me edukatoren Filomena vendosëm të dalim së bashku në qytet. Kështu, e lamë mënjane stresin dhe lodhjen nga testet që nuk kishin të ndalur. Pasi hëngrëm darkë, vendosëm të shkonim dhe të argëtohemi në parkun e lojërave "Luna Park" në Prizren. Çdo gjë të përkujtonte fëmijërinë, e ne dukeshim si fëmijë të llastuar, të cilët vrapojnë pas çdo lodre. Sfida më e madhe për ne ishte anija, ku nga lartësia e madhe frikësoheshim të gjitha. Bërtisnim me të madhe dhe na dukej sikur s'do të zbrisnim më gjallë në tokë. Mendonim për të mirat që i ka jeta dhe për të gjitha ato gjëra të cilat ndonjëherë i kemi nënvlerësuar. Pasi zbritëm, vrapuam pas lodrave tjera dhe harruam frikën që patëm.

Çdo njeri dëshiron që edhe një herë të jetë fëmijë, sepse vetëm atëherë e ke në dorë një lodër të vërtetë, sepse kur të rritesh, në dorë ke vetëm atë lodër që jeta ta ofron.



### Bora e madhe Valza Bytyçi – XI a

Si duket dimri që lamë pas nuk deshi fare ta zhvishte vellon e tij të bardhë e të gjatë. Ishte vërtet një dimër që do të mbahet mend gjatë. Bora nuk njihte kufij, binte pandalur deri sa na mbuloi krejtësisht. E shikonim nga dritaret, po përse të mos e shijonim?

Që ta thyenim monotoninë dolëm jashtë të gjithë nga konvikti të luanim në borë. Jashtë ç'të shihnim! Të gjithë duke e hedhur njëri-tjetrin në borë. Disa hidheshin në borë e disa vraponin të shpëtonin nga topat e borës. Sa fytura të qeshura shihje atë ditë. Ato të qeshura e zbukuronin edhe më shumë borën e bardhë.

Edhe ne, si natyrën, na mbuloi bora, të gjithëve na veshi me të bardhë. Atë ditë nuk munguan as fotografitë e shumta që bëmë, sepse si gjithmonë janë e vetmja mënyrë që ne ta ndalim kohën dhe ato çaste të bukura që kaluam. Ishte vërtet një kënaqësi e veçantë. Jo shpesh përjetojmë çaste të tilla.

Por, kot nuk thonë që çdo gjëje të bukur i vjen fundi shpejt. Kështu, erdhi koha për mësim dhe ne hymë brenda, ashtu të lagur duke lënë pas gjurmët tona në borë.



## Konvikt

### Vizita në Gadime Arbnora Duhanaj – X c



Ishte ditë e bukur. Të gjithë konviktorët, fillimisht shkuam për vizitë në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë. Aty kaluam mjaft bukur e pastaj shkuam për një vizitë në fshatin Gadime, për të vizituar shpellën e njohur të mermertë.

Ishte kënaqësi e madhe të shikoje atë mrekulli të krijuar nga vetë nëna natyrë. Sytë e secilit nga ne shkëlqenin nga ajo bukuri me kristale të rralla, të krijuar nga shkëmbinjtë.

Me shoqërinë diskutonim për ato që po shihnim, sepse aty na dukej çdo gjë interesante. Ne morëm informacione të shumta rreth zbulimit të kësaj shpelle nga ciceroni i cili na shoqëroi gjatë tërë kohës. Zbulimi i kësaj shpelle është me të vërtetë interesant, sepse kjo shpellë dikur e pazbuluar, gjendet në oborrin e një fshatari, i cili duke gërmuar e zbuloi këtë mrekulli të natyrës.

Shoqëria është gjë me vlerë të veçantë, prandaj edhe kënaqësia ishte shumë e madhe që së bashku ta vizitonim shpellën e Gadimes. Këtu kaluam shumë mirë dhe në kujtesën tonë mbetën kujtime të bukura nga kjo vizitë.



## Internat

### Përshtypje nga orët e mësimit në konvikt Arlind Morina – VI a



Ora e parë e mësimit në konvikt ishte shumë e mirë dhe më ka lënë mjaft përshtypje.

Nuk mund ta harroj çastin kur të gjithë shokët e konviktit u mbledhëm bashkë me edukatoren dhe filluam të mësonim. Kur unë kisha nevojë për të më ndihmuar rreth detyrave që s'i kuptoja, më ndihmonin të gjithë shokët, që për mua ishte kënaqësi e vërtetë.

Më pëlqejnë shumë shokët e konviktit, sepse ata janë të sjellshëm me të gjithë. Kur ne mësojmë, është një qetësi e madhe dhe të gjithë mundohen të përfundojnë obligimet dhe detyrat që kanë. Mua më pëlqejnë orët e mësimit në konvikt, sepse për çdo problem ne konsultohemi me njëri-tjetrin.

Detyrat nuk janë shumë të rënda, pasi kemi çdoherë ndihmën e motrës Angjelinë dhe shokëve të tjerë të konviktit.

### Në Loyola-Gymnasium – duke ndjekur rrugën e vëllait Kolë Mirdita – VI b



Që herën e parë kur e kam vizituar këtë shkollë, më është dukur shumë e mirë. Tani që jam pjesë e saj, jam tejet i lumtur.

Të gjithë edukatorët na pritnin tek dyert e konvikteve, pastaj shkua me grupi ynë ku edukatorja na priti me plot gëzim. Unë menjherë bëra shokë, të cilët me përkrahnin shumë.

Ditën e parë në shkollë e kalova shumë mirë. U takova edhe me mësuesit dhe mua ajo ditë më pëlqeu shumë. Shpresoj që edhe ditët e tjera do t'i kaloj kështu. Ambientin në konvikt e njihja edhe më herët, ngase vija shpesh të vizitoja vëllanë tim që mësonte e jetonte këtu. Edukatorja më përkrah shumë, ashtu si edhe vëllai im i madh.

Shpresoj që këtë vit ta kaloj mirë me edukatorët, mësuesit dhe shokët.

## Konvikt

### Takim me artistë Erijona Shoshi – XI c



Të gjithë ne kemi një pasion në vete dhe luftojmë me të gjitha forcat tona që ta realizojmë atë.

Akrimi ishte ëndrra e këtij njeriu dhe vazhdon të jetë për tërë këto vite. Është ky aktori Xhevdet

Doda – përfaqësues i teatrit të Prizrenit. Ai ishte i pranishëm para të gjithë nxënësve të konviktit. E dëgjoni me ëndje dhe kureshtje. Teatri, skena, aktrimi, të gjitha këto ishin jeta e tij. Ne parashtronim pyetje e ai përgjigjej pa ndonjë mundim. Çdonjëri prej nesh aty mori një porosi nga ai: Ta realizojmë ëndrrën që e kemi për studime.

Ajo na shpie në jetën që kemi përpara dhe na bën krenarë për atë se çfarë kemi arritur. Atë natë mësuam gjithçka përreth aktrimit në Kosovë dhe për fillet e tij. Tregonte çdo gjë, nuk kalonte as edhe një detaj të vetëm. Kaluam me të vërtetë momente të paharueshme.



### Ditët e fundit në konvikt Leon Rexhepi – VII b



Ditët e fundit në konvikt ishin shumë të mira, pak me vapë, por ne u kënaqëm shumë, duke luajtur sporte të ndryshme duke kaluar kështu ditë të paharueshme. Çdo ditë e kalonim me lojëra të shumta; duke u zbatuar me shokët e shoqet, me të cilët kaloja shumë mirë.

Kështu kalonin ditët të cilat dëshiroja të mos mbaronin kurrë, por dita që mua më la më së shumti përshtypje ishte dita që e kaluam me motrën Angjelinë. Ajo na mësoi shumë lojëra të reja, që ne nuk i kishim ditur më parë e të cilat na pëlqyen shumë. Edhe kësaj dite i erdhi fundi, e dalëngadalë, gjithë vitit shkollor. Ishte ditë e vështirë ajo ditë kur po ndaheshim me njëri-tjetrin, sepse po shkonim në pushim e gjithë ai gëzim në fund na mërziti pak.

U ndamë duke i uruar njëri-tjetrit pushime të këndshme verore, që shtatori të na gjejë të gjithëve sërish bashkë, me energji të reja në vitin vijues shkollor.



## Internat – Konvikt

### Një e diel jo e zakonshme Mërgimtare Berisha – XI d



Një të diel pasdite, edukatorja Filomena Laçi, bashkë me disa vajza konviktoze, organizoi një mbrëmje të mrekullueshme në konvikt. Ne, vajzat e grupi "Sirenat", nuk pushuam fare, e ndienim veten sikur të ishim tjera. Disa prej nesh e morën përsipër të na zbukuronin flokët, e disa të tjera të na bënin grimin. Pas një kohe të shkurtër e filluam punën. Koha vetëm po ecte dhe kaloi shpejt.

Kishim 30 minuta kohë për ta ndryshuar pamjen, për ta bërë grimin dhe për t'i ndrequr flokët, dhe më në fund, e arritëm atë që e kërkonim prej kohësh. Dhomat tona kishin filluar të bëheshin rrëmujë. Në ato çaste erdhi edukatorja jonë, që ne në shenjë respekti e thërrasim teta File. U habit aq shumë nga ndryshimi ynë e nuk shikonte asgjë tjetër përveç nesh. Ajo ishte shumë e lumtur nga rezultati, që përbrenda 30 minutash ne arritëm që të shndërroheshim në figura tjera. Pas pak erdhi koha të dilnim në dhomën e përbashkët për t'i shikuar edhe vajzat e tjera sesi kishin ndryshuar. Aty kishin sjellë disa fustane, të punuara me dorë nga disa nxënëse tjera të Loyola-Gymnasium.

Ne i morëm në dhoma dhe i veshëm, por kur dolëm në dhomën e përbashkët ajo ishte e mbushur me plot vajza të grupeve tjera, që nuk kishim menduar që ajo e dielë do të bëhej aq e rëndësishme. Filluam të bënim sfilatën e cila nuk ishte në listën tonë të ditës.

Juria vendosi se cila do të zgjedhet nga ne modelja më e mirë. Në ato momente u ndiem sikur të ishim "yje të modelizmit". Ajo e dielë do të mbetet gjithmonë në kujtesë nga jeta jonë në Loyola-Gymnasium.



## Schule – Shkolla

### Customs & Traditions Edina Osmankaj and class VIII b



Every country has its own customs and traditions. Visitors from other countries should know some of the customs and traditions of the country they are visiting beforehand. That's why we as a class, the VIII b, prepared some notes on the customs and traditions of our country:

- One of the Albanian traditions is respect for others and especially for guests. We serve them the best meals that we can afford.
- We don't start to eat lunch until the eldest of the family comes. When he comes and says that we can start, then we start to eat.
- When something happens like death, marriage, childbirth, or even buying a house or a car, cousins and friends go to that person's house to congratulate or to comfort him (when somebody died).
- When guests come to us we don't ask them what they want, but we try to serve them the best meals we have.
- Usually when someone starts building a house they slaughter a sheep and take its head off and then they start to build the house on it.
- Here in Kosovo we usually put the flag on top of houses, buildings or squares during construction and the flag is exposed until the end of the construction

of a facility or a home.

- In my town it is custom to say "hajde mas darke" which means "come after dinner". It is used when you see a friend or a cousin and you want to drink a tea or a coffee with them. By saying this, they understand that they should have dinner at home.
- In my city usually people hang a horseshoe on the door of their home or in the car. People say it brings luck. It is also a sign of luck if somebody finds a horseshoe anywhere.
- Easter is a catholic celebration where people decorate eggs. On Easter day people should wake up early and prepare the breakfast. But they can only eat cheese, eggs and blessed bread.
- When Easter approaches, some days before, people begin to decorate eggs with different colours. These eggs are blessed and when people come we should give them as many eggs as they are.
- When Bajram comes women usually try to make a good lunch with different meals. The whole family gets together and has a feast.
- When it is Bajram a lot of guests come. We serve them cakes and they give money to the children.
- For Bajram people stay just for a short time because they should go to other places as well. They visit all their cousins.
- In Kosovo there are always huge weddings, they can last for weeks some times. Those who get married invite a lot of people.
- When a girl gets married and goes to the bridegroom's house on the second day the bride's women cousins come for a

## Schule – Shkolla

### Customs & Traditions

visit. The bride stays in her room and her cousins give her presents.

- ▶ In my city brides always wear white dresses. When they come to the bridegroom's house somebody puts a child on her lap and then she gives him something (usually money).
- ▶ When a girl gets married, a day before, her family celebrates it and the bridegroom's cousins come also. For this celebration only girls and women are invited.
- ▶ When the bridegroom's cousins go to take the bride, someone holds the Albanian flag. He has to walk in front of the party. In Albanian he is called "bajraktari".
- ▶ For weddings we have our traditional costumes: For men they are called "tirqi" while for women "jelek i arit", which means golden vest.
- ▶ When the bride leaves her house and goes to her husband's house, it's a tradition to spread honey at the door. They say if you do that you will have a life sweet like honey.
- ▶ Earlier boys didn't choose which girl to marry. The parents chose a wife for them. And the soon-to-be husband and wife didn't see each other until the wedding day.
- ▶ Based on tradition and to protect the honour of the family, when one of the brothers died, his wife got married with the other brother. Usually these marriages were only to have somebody to take care of the children.
- ▶ When a woman gives birth to a child they celebrate a "party" which is called "babina". They eat lunch and then as a dessert baklava is served. After that the women begin to dance to traditional music.



## Internat – Konvikt

### Arti dhe misteri i tij Elegji Mehmetaj – XI d

Ndonjëherë nuk mjafton një jetë për të kuptuar disa gjëra, por ndonjëherë mjafton një moment për të arritur deri tek mesazhi dhe vlera e atij momenti. Ajo ishte një ditë e mrekullueshme, e organizuar shumë mirë. Ne, si pjesë e asaj dite, kaluam disa çaste shumë domethënëse, që në njëfarë mënyre paraqitnin realitetin e jetës sonë.

Ekspozita e fotografive të ndryshme, të bëra nga njerëz të ndryshëm, ishte shumë e bukur. Një pjesë e tyre, dua ta veçoj për arsye se aty bëhej fjalë vetëm për një objekt, po që paraqitej në dimensione të ndryshme, të pakuptueshme, ashtu siç është edhe vetë jeta jonë.

Pas kësaj, shkuam në kinemanë e Prishtinës për të parë filmin që do të shfaqej. Edhe aty kishte momente me mesazhet e tyre, ku secili nga ne i kemi në mendjen tonë. Duhet të pritnim rreth një orë, në mes të turmës së njerëzve, pëshpëritjeve të tyre dhe ngjyrave që i jepnin gjallëri Prishtinës, për të arritur dalëngadalë te fundi i udhëtimit tonë.

Arritëm të hynim në një botë tjetër, e ndërtuar nga njerëzit, nga imagjinata e tyre. Çdo gjë ishte e bukur, por e errët. Dukej qetësi, por ishte zhurmë e madhe. Gjërat e imagjinatës tonë, që i mendojmë të pamundura, aty ishin realitet. Secila pjesë e asaj bote paraqiste diçka të mirë e diçka të hidhur nga jeta jonë.

Por arti i kishte zbukuruar të gjitha. Koha kalonte e bashkë me të, edhe ajo ditë me shumë mbresa dhe çaste të paharrueshme.



## Ekskursioni në Durrës Leonita Krasniqi – X d



Të fillosh me një mendim kritik, vlerëson vlerën e diçkaje, por ta mendosh atë se sa kritike do ishte për ty se ke një mendim të gabuar, thjesht, në mendjen tënde ke futur një improvizim të shtjelluar. Askush nuk e di se sa e ëmbël është jeta, por të gjithë nisen duke e marrë jetën si diçka të hidhur dhe shumë arrogante, derisa nuk arrijnë të të kuptuarit e asaj se pse jetojmë dhe çfarë duhet bërë ta arrijmë çelësin e lumturisë.

Këtë çelës unë e gjeta fare lehtë në Loyola-Gymnasium, e sidomos ditën që kaluam një fundjavë në Durrës. Pas shumë aktiviteteve, një ditë vendosëm që ta kalojmë një fundjavë në bregdetin e Durrësit. Në këtë ekskursion të shkurtër, por me kuptim, kaluam çaste të paharrueshme. Jemi argëtuar, jemi shmangur nga ditët stresuese e kemi kaluar në një pushim e lehtësim shpirtëror. Në fillim vizituam qytetin e vjetër të

Durrësit, amfiteatrin, pastaj u vendosëm në hotelin ku do të kalonim natën. Pas një udhëtimi të lodhshëm, hëngrëm drekë, me ushqime të shijshme që na prisnin në tryezë.

Më pas u përgatitëm të shkonim në plazh për t'u freskuar, çast që e kishim pritur shumë gjatë që ta kalonim një ditë së bashku. Kështu ishte fillimi i këtij pushimi dyditor, ku në fytyrën e secilit mbizotëronte gëzimi, hareja dhe të gjithë dukeshin të entuziazmuar. Pushimi kaloi pa ndonjë problem, dhe ne të gjithë kaluam një kohë të mirë, që do ta kemi në mendje si një ndër pushimet më të hareshme me shoqërinë tonë të re, që ka vetëm një vit njohjeje.

Pra ky ekskursion në vete ngërtheu një kënaqësi me çaste të lumtura. Kështu jetëgjatësia nuk varet nga vitet që kalojmë, por nga lumturia që përshkon çastet e jetës sonë.



## Ekskursioni në Durrës Donika Nushi – XII c

Tre vjet të tëra bashkë, me momente të bukura, momente brengosjeje, mërzie, mungese. Të gjitha i kaluam pranë njëri-tjetrit. Ishin ditët përmbyllëse të kësaj periudhe trevjeçare, kështu që etja për përjetime që do t'i mbyllim thellë në kujtesën tonë, ishte e pranishme. Një ndër të mirat e konviktit është, që nëse organizohet diçka siç duhet, atëherë edhe mund të realizohet. Ne ishim gjenerata e parë që dolëm jashtë shtetit për rekreacion (si konviktore).

Mirëpo nuk do të jemi të fundit, sepse përvoja që patën edukatorët tanë me ne, mundëson që edhe maturantët tjerë të vazhdojnë një aktivitet të tillë. Ideja për udhëtimin dyditor në Durrës, ishte dhënë disa javë më parë, mirëpo ne u nisëm atëherë kur çdo gjë u rregullua me mjetin e transportit, me vendin ku do të qëndronim dhe se si do ta kalonim kohën atje. Nuk ishte kohë e gjatë që kaluam atje, mirëpo përplot me momente të vlefshme, gjithmonë në rreth miqësor. Ishte një mundësi e mirë për t'u relaksuar para provimeve vendimtare për të ardhmen tonë, kështu që e shijuam me kënaqësi.

Çaste të bukura përjetuam në pishinën e hotelit të rregulluar mirë, ku zhytja, loja dhe buzëqeshjet me zë të lartë, ishin të pashmangshme. Shfrytëzuam gjithashtu ujin e detit, edhe pse ishte fillimi i majit, por uji kishte temperaturën e duhur për larje. Këngët e shumta, prej një anijeje në tjetrën, ishin pjesë e një ndjenjeje të re. Më pas arritëm të shohim nga afër dhe të ecnim në pjesën më të frekuentuar të qytetit, në qendër të Durrësit. Provuam ndonjë ushqim të veçantë, arritëm të bënim fotografi të përbashkëta, për të pasur kështu një mënyrë kthimi të shpejtë në këtë kohë, pas disa vitesh. Patëm mundësinë të përjetojmë një kënaqësi që do të donim ta përsëritnim, sepse pos kohës së mirë që njeriu kalon gjatë



## Internat

### Ekskursioni në Durrës

të organizimeve të tilla, ndodh që të bëhemi më të kuptueshëm dhe më të afërt me njëri-tjetrin.

Në këtë rast nuk mund të mos i përhëndes dhe falënderoj dy edukatorët tanë, që nuk kursyen asgjë për ne, ed. Arianit Çollaku dhe edukatoren, e njëkohësisht drejtoreshën e konviktit, m. Klara Curri, e cila përkundër angazhimeve të shumta rreth funksionimit sa më të mirë të konviktit, gjeti kohë për të na plotësuar dëshirat dhe të marrë përgjegjësi në këtë ekskursion.



## Konvikt

### Kampimi në Rugovë Fjolla Shala – XII c



Ne, si maturantë, e filluam këtë vit të fundit shkollor me shpresa të mëdha, por edhe me brenga të reja.

Si lehtësim, në këtë fillim të ri, zgjodhëm një shëtitje gjatë fundjavës. Ndër më interesantet na u duk kampimi në Rugovë të Pejës. Për marrjen e këtij vendimi na nxitën pamjet e bukura që mund të përjetonim të gjithë së bashku. Ne nuk prisnim që do të ishte aq bukur.

Rrugës na shoqëruan buzëqeshjet, e mbi të gjitha kënaqësia. Ishim nën shoqërimin e dy edukatorëve tanë, m. Klara Curri dhe ed. Arianit Çollaku, të cilët padyshim që vetëm me pranimin e tyre na bënë të ndiheshim shumë më të sigurtë dhe të lumtur. Zbritja jonë u përçoll me brohoritje të shumta. Ajo që na gëzoi më shumë ishte lajmi se do të qëndronim të gjithë së bashku në një kamp-shtëpizë, ku do të kënaqeshim edhe më shumë.

I vendosëm çantat dhe filluam përgatitjen e ushqimit dhe vendosjen e pajisjeve të muzikës. Habiteshim me afërsinë që kishim krijuar brenda këtyre tri vitesh. Tashmë të gjithë ndiheshim si anëtarë të një familjeje të madhe. Muzika na shoqëronte në çdo moment, ashtu si edhe vallëzimi, barcaletat e fotografimet. Gjithçka ishte e përsosur. Atë natë qëndruam deri vonë së bashku për të vazhduar më pas bisedat në dhomat tona, por këtë radhë jashtë konviktit.

Të nesërmen u zgjuam të lumtur për natën që kaluam aty. Pas kthimit në konvikt do të ishim përsëri bashkë, por jo me pamjen mbresëlënëse, andaj mundoheshim që të shfrytëzonim sa më shumë natyrën. Për drekë ndaluan në Shkukëz, gjithashtu një vend me një ambient mjaft të mirë e të pastër. Më pas kaluam disa orë në qytetin e Gjakovës dhe patëm mundësi që të ndiqnim edhe një ndeshje futbolistike.

Kur u kthyem në konvikt ishim mjaft të lodhur, por prapa asaj lodhjeje ishin kënaqësitë që përjetuam në atë kamping.

Tani fotografitë mbeten si dëshmi për një fundjavë të përkryer. Ky do të jetë gjithmonë një kampim i veçantë dhe besoj i papërsëritshëm për të gjithë ne. Ndihehem shumë e lumtur që kam miq që e mbushin albumin tim me kujtime të pashlyeshme.



## Besucher & Besuche

### Besucher in Prizren Unsere Besuche



20. – 23.10.2011  
Michael Schönwälder  
medienservice farbsatz  
Workshop – Schülerzeitung



27.10.2011  
Oberstarzt  
Dr. med. Harald Siemon  
Kommandeur des dt. Ein-  
satzkontingents KFOR



28.10.2011  
16. Sitzung  
Trägervereins – ALG



08.11.2011  
Dr. Boris Menrath, Fachbera-  
ter – ZfA Belgrad und Peter  
Caesar, Fachschaftsberater –  
ZfA Pristina



23.11.2011  
Dr. Ernst Reichel  
Botschafter der Bundesrepu-  
blik Deutschlnad – Pristina



24. – 27.11.2011  
P. Stefan Kiechele SJ  
Provinzial der Deutschen  
Provinz der Jesuiten



01.12.2011  
Chaplains meeting am  
Loyola-Gymnasium



19.12.2011  
P. Happel trifft Bundeskanz-  
lerin Dr. Angela Merkel



09.01.2012  
P. Krystian Sowa SJ



08. – 12.02.2012  
Firmenvertreter stellen, im  
Rahmen der Ausbildungs-  
initiative, ihre Betriebe und  
Ausbildungsangebote vor



20. – 21.02.2012  
Prof. Dr. Christian Schwarz-  
Schilling und Dr. Vilson  
Mirdita, Botschafter der  
Republik Kosovo in Berlin



19.03. – 02.04.2012  
P. Peter Leutenstorfer

## Mysafirët & Vizitat

### Mysafirët në Prizren Vizitat tona



28.02. – 04.03.2012  
Sr. Brigitte Gölles  
Generaloberin der Grazer  
Schulschwwestern



04.03.2012  
Msgr. Mag. Christian Werner  
Österreichischer Militärbi-  
schof



08.03.2012  
Delegation des Innenaus-  
schusses des Thüringer  
Landtages



12.03.2012  
Oberst Bernd Holthusen  
Kommandeur des dt. Ein-  
satzkontingents KFOR



24.03. – 07.04.2012  
17 unserer Schüler fahren  
zu Betriebspraktika nach  
Deutschland



14.04.2012  
17. Sitzung  
Trägervereins – ALG

## Besucher & Besuche

### Besucher in Prizren Unsere Besuche



14. – 21.04.2012  
Schüleraustausch  
Schüler und Lehrer vom  
Friedrich-List-Gymnasium,  
Gemünden in Prizren



18.04.2012  
Hellmut Königshaus  
Wehrbeauftragter des  
Deutschen Bundestages



30.04.2012  
Delegation  
Berliner Presseclub e.V.



12. – 19.05.2012  
Schüleraustausch  
Schüler und Lehrer vom  
Loyola-Gymnasium in  
Gemünden



30.05. – 06.06.2012  
2 Schülerinnen nehmen am  
Europamarathon in Görlitz  
teil



02.06.2012  
P. Walter Happel besucht  
Haxhi Dede Edmond Brahimi  
Oberhaupt des Bektashi-  
ordens



19. – 21.06.2012  
Hr. Böhm und Hr. Schneider  
Alumni der Jesuitenschulen  
Österreichs



22.06.2012  
Oberst Hans H. Matthies  
Kommandeur des dt. Ein-  
satzkontingents KFOR



27.06.2012  
P. Walter Happel wird durch  
die Präsidentin Atifete Jahja-  
ga ausgezeichnet



28.06.2012  
Milena Wendering  
Leiterin des Pressereferats  
der Deutschen Botschaft,  
Pristina



06.07.2012  
P. Walter Happel SJ  
Vortrag beim Firmenjubi-  
läum von Haver & Boecker



21.08.2012  
Oberst Hans H. Matthies  
Kommandeur des dt. Ein-  
satzkontingents KFOR

## Mysafirët & Vizitat

### Mysafirët në Prizren Vizitat tona



07.09.2012  
P. Walter Happel nimmt am  
Kommandowechsel der KFOR  
in Pristina teil



12. – 15.09.2012  
P. Eugen Hillengass SJ  
"Der Vater des Loyola-  
Gymnasiums"



13.09.2012  
P. Walter Happel nimmt am  
Abschiedsempfang, von  
Botschafter Dr. Ernst Reichel,  
in Pristina teil



13.09.2012  
Polizeidirektor Otto K. Rohde  
Kommandeur des Deutschen  
kontingents EULEX



25.09.2012  
Delegation aus Emden und  
Zym



05.10.2012  
Erzbischof Juliusz Janusz  
Apostolischer Nuntius,  
Slowenien

**Der Förderverein (AG Münster – VR 70758)**

ist zur ideellen und materiellen Unterstützung der Asociation "Loyola-Gymnasium" am 22. März 2007 als eingetragener Verein gegründet worden. Er soll darüber hinaus den Schüleraustausch zwischen dem Gymnasium in Prizren und deutschen Schulen vermitteln und fördern. Diese Vereinszwecke werden durch Mitgliedsbeiträge und Spenden realisiert.

**Spendenkonto**

|             |                        |
|-------------|------------------------|
| Bank        | Volksbank Beckum eG    |
| Kontonummer | 103 16 26 00           |
| BLZ         | 412 600 06             |
| IBAN        | DE50412600060103162600 |
| SWIFT(BIC)  | GENODEM1BEK            |

Bitte geben Sie im Verwendungszweck Ihren Namen und Ihre Anschrift an. Nur dann können wir Ihnen eine steuerlich anerkannte Spendenbescheinigung zusenden. Der Versand erfolgt automatisch im Januar des Folgejahres.

**Anschrift**

Holtmar 13  
D – 59269 Beckum

**Telefon**

+49 (0) 2521 58 51  
+49 (0) 8151 911 700

**E-Mail/URL**

verein@alg-prizren.com  
www.alg-prizren.com

**Vorstand**

Dirk Komitsch  
Finanzen  
Michael Werhahn-Röttgen  
Vorsitzender  
Peter Tiggesbäumker  
Schriftführer  
Jürgen Schwarzbach  
Stv. Vorsitzender

**Meine persönlichen Daten:**

Name, Vorname\*

Firma

Straße\*

Land/PLZ/Ort\*

Telefon

E-Mail\*\*

Hiermit ermächtige ich Sie widerruflich, meinen Beitrag oder meine Spende mittels Lastschrift einzuziehen. Meine Kontoverbindung lautet:

Bank\*

Kontonummer\*

BLZ\*

Datum/Ort/Unterschrift\*

\* Felder müssen immer ausgefüllt werden!

\*\* E-Mail-Adresse eintragen und zukünftig, kostenlos ALG News erhalten.

Durch meine Mitgliedschaft im Förderverein und/oder meine Spende unterstütze ich die Erziehungs- und Bildungsarbeit am Loyola-Gymnasium.

**Ich spende!**

Meine Spende beträgt:

\_\_\_\_\_ EUR

bitte eintragen

**Ich werde Mitglied!**

Mein jährlicher Mitgliedsbeitrag beträgt:

- ☐ 24 EUR  
☐ 48 EUR  
☐ 96 EUR

\_\_\_\_\_ EUR

bitte ankreuzen oder eintragen

Die Seite bitte ausfüllen, heraustrennen und per Post senden an:

Freunde und Förderer  
der Asociation  
"Loyola-Gymnasium" e. V.  
Michael Werhahn-Röttgen  
Holtmar 13  
D – 59269 Beckum

## Spendenkonto

### Jesuitenmission

**Bank:** Liga Bank  
Vordere Sterngasse 32  
D - 90402 Nürnberg

**Kontoinhaber:** Jesuitenmission  
Königstr. 54  
D - 90402 Nürnberg

**Kontonummer:** 5115582  
**BLZ:** 75090300  
**IBAN:** DE 61 75090300 0005115582  
**SWIFT(BIC):** GENODEF1M05  
**Stichwort:** Loyola-Gymnasium Prizren

Zuwendungsbescheinigungen werden erstellt.

## Kontoja e donacioneve

### Förderverein

**Bank:** Volksbank Beckum eG  
Südstraße 15  
D - 59269 Beckum

**Kontoinhaber:** Freunde u. Förderer der ALG e.V.  
Holtmar 13  
D - 59269 Beckum

**Kontonummer:** 103162600  
**BLZ:** 41260006  
**IBAN:** DE 50 41260006 0103162600  
**SWIFT(BIC):** GENODEM1BEK

Zuwendungsbescheinigungen werden erstellt.



Copyright © 2012 Asociation "Loyola-Gymnasium"

[www.alg-prizren.com](http://www.alg-prizren.com)

